



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE



PROCESVERBAL
KOMITETI SEKTORIAL I
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE KOMUNIKIMIT

RENDI DITËS

1. Regjistrimi dhe mirëseardhja
2. Zgjedhja e kryetarit të ri të KS
3. Diskutim për kualifikimet e reja dhe ato ekzistuese, afatgjata dhe afatshkurtra
4. Përcaktimi i agjendës për takimin e radhës

➤ Shënime nga zhvillimi dhe diskutimet e mbledhjes së Komitetit Sektorial:

1. Regjistrimi dhe mirëseardhja

Takimi u hap nga **znj. Ejvis Gishti**, Drejtor i Përgjithshëm i AKAFPK-së, e cila falenderoi pjesëmarrësit për prezencën. **Znj. Gishti** e nisi takimin duke i uruar mirëseardhjen **z. Julian Demeti**, përfaqësues i AITA-s dhe shprehu kënaqësinë që z. Demeti do i bashkohet KS, duke qenë se, ka vite që kontribuon në fushën e TIK dhe është njohës shumë i mirë i zhvillimeve në këtë fushë. Në vijim fjalën e mori **z. Demeti**, i cili shprehu kënaqësinë që ishte pjesë e këtij Komiteti. **Z. Demeti** tha se, ka 15 vjet që është në fushën e IT, drejton 3 kompani në këtë sektor dhe njëkohësisht prej 6 vitesh është anëtar bordi i AITA-s. **Z. Demeti** theksoi se, secili prej anëtarëve dhe ekspertëve të IT duhet ta ndjejë veten faktor dhe duhet të japë kontribut sa më shumë që të jetë e mundur në mënyrë që, të ndjekin ritmet e shteteve të tjera dhe zhvillimeve që ndodhin në botë në fushën e IT-së. **Znj. Gishti** theksoi se, shteti është promotor i zhvillimeve por është sektori privat që artikulon nevojën për ndryshime dhe përmirësime në ofertën e arsimit dhe formimit profesional, ndaj dhe Komiteti me përbërjen e tij është shumë i rëndësishëm në këtë mision. Në vijim, **znj. Gishti** prezantoi agjendën e takimit dhe vijoi me pikën e radhës.

2. Zgjedhja e kryetarit të ri të KS

Znj. Gishti tha se duhet të zgjedhin kryetarin e ri të KS, ndaj anëtarët ishin të lirë të propozonin kandidaturat e tyre, për të kaluar më pas në votim. **Z. Demeti** mori fjalën duke thënë se, kryetari

i KS duhet të ishte një person që së pari ka dëshirën për të qenë në atë pozitë dhe që ta shtyjë përpara këtë mision dhe së dyti të ketë kohën e nevojshme në dispozicion për t'iu dedikuar detyrës. Ndaj ai do propozonte si më të përshtatshëm z. Likaj ose z. Xhina.

Z. Gentian Likaj tha se, z. Xhina është më i përshtatshëm duke qenë se vjen nga akademia, ka aspekt të gjerë dhe eksperiencën e ka shumë të mirë, ndaj e propozoi si kandidat. **Z. Endri Xhina** mori fjalën duke falënderuar z. Likaj dhe z. Demeti për vlerësimin. Ai tha se, për momentin ishte në një fazë të ecurisë profesionale që kishte dhe kohën në dispozicion dhe dëshirën për t'u marrë me këtë gjë, kështu që do e merrte përsipër këtë pozicion me vullnetin më të mirë për ta çuar përpara. Duke qenë se, ishte vetëm një kandidaturë e propozuar, anëtarët kaluan në votim dhe miratuan një zëri kryetarin e ri të KS, z. Xhina.

3. Diskutim për kualifikimet e reja dhe ato ekzistuese, afatgjata dhe afatshkurtra

Në vijim të agjendës, **znj. Diana Xhelili** u prezantoi anëtarëve vendimet e marra nga Komiteti Sektorial përgjatë mbledhjeve të kaluara, si dhe me ofertën e kualifikimeve afatgjata dhe afatshkurtra ekzistuese.

Znj. Gishti tha se, të gjitha kualifikimet afatgjata janë rishikuar gjatë vitit 2020 - 2021, që do të thotë se duhet të rishikohen sërish gjatë vitit të ardhshëm. Në këtë mënyrë në çdo kualifikim do të pasqyrohen rekomandimet që kanë bërë anëtarët për “*Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit*”, niveli II i KSHK-së, “*Programim*”, niveli IV i KSHK-së, “*Multimedia*”, niveli IV i KSHK-së etj. **Znj. Gishti** shtoi se, qeveria shqiptare ka vendosur të fillojë në shtator pilotimin e sistemit dual për 6 kualifikime dhe mes tyre është dhe “*Multimedia*”. Ky sistem parashikon që nxënësi do të kalojë më shumë kohë në biznes, sidomos gjatë vitit të tretë, pasi në vitin e katërt formimi përqëndrohet tek përgatitja për maturën shtetërore.

Po kështu, nga shtatori shkollat do të kenë mundësi të ofrojnë kualifikimin e “*Sigurisë kibernetike*”, kualifikim pas të mesëm me kohëzgjatje dy vjeçare, që ishte propozim i KS. Një tjetër propozim ka qenë ofrimi i kursit pas të mesëm për “*IT support specialist*”, për të cilin anëtarët duhet të marrin vendimin nëqoftëse është i nevojshëm apo jo. **Z. Likaj** komentoi se, “*IT support specialist*” është shumë i rëndësishëm për kompanitë të cilat e kanë të vështirë të gjejnë punonjës afatgjatë në atë pozicion pasi punonjësit me bachelor e shohin si pozicion trampolinë.

Znj. Luljeta Dauti shtoi se, në ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit ka vazhdimisht ankesa pasi punonjësit që kanë një kualifikim të nivelit të V paguhen njësoj si ata që kanë një kualifikim të nivelit të IV dhe ndoshta kjo do rregulluar. **Z. Demeti** tha se, kjo mund të jetë e vlefshme për institucionet shtetërore por në privat pagat nuk i përcakton niveli i kualifikimit por pozicioni që mbulon dhe sigurisht kërkesë - oferta. **Znj. Gishti** shpjegoi se KS nuk ndërhyt dot lidhur me pagesat apo kriteret që përcaktohen për rekrutim. Komiteti duhet të

vlerësojë vetëm nevojën për një kualifikim në treg. Anëtarët ranë dakord se një kualifikim pas të mesëm për “*IT support specialist*” është shumë i nevojshëm në treg.

Znj. Dauti pyeti në rastin se, ishte momenti të mendonin edhe për një kualifikim të dedikuar për Inteligjencën Artificiale (IA), nisur nga zhvillimi që po merr sot në botë por **z. Demeti** propozoi që brenda “*IT support specialist*” mund të integrohet në kurrikul një pjesë për IA. Në plotësim të kësaj, **znj. Irena Malolli** propozoi që IA të integrohet tek të gjitha kurrikulat që do të rishikohen. Po kështu, **znj. Malolli** solli në vëmendje një interes të shtuar gjatë muajve të fundit për gjysmëpërçuesit. Ndoshta anëtarët mund të studiojnë pak tregun deri në mbledhjen e ardhshme dhe të diskutojnë se si mund të qasen ndaj kësaj nevoje. Aktualisht, në drejtimin e elektroteknikës ka të integruar në kurrikul një modul për gjysmëpërçuesit, por mund të vlerësohet në rastin se mund të shtohet diçka ose të dalë si një kualifikim më vete.

Sa i përket kurseve afatshkurtra, **znj. Gishti** shpjegoi se, ato ofrohen nga qendrat profesionale publike dhe AKAFPK ka një rol të pjesshëm, pasi përgatit kurrikulat vetëm për kurse me interes kombëtar pra, kurset e unifikuara. Kurset me bazë qendre përgatiten nga vetë qendrat. Nisur nga gjetjet e Studimit të Nevojave të Aftësive (SNA) në treg për TIK, rezultoi i nevojshëm ofrimi i kursit për “*Zhvillim front-end-i*” dhe “*Hedhje të dhënash (Data Entry)*” të cilat AKAFPK i ka përgatitur dhe janë gati për t’u ofruar nga qendrat.

Znj. Hatixhe Bilibashi propozoi se mund të ofrohet si kurs afatshkurtër 3 ose 6 mujor krahas front end -it dhe back end-i, si dhe një kurs për “*Software-in*”. **Z. Xhina** propozoi se ndoshta kurset afatshkurtra mund të fokusohen tek framework-et, të cilat janë të domosdoshme për kompanitë por që nuk zhvillohen as në universitete. Kurset mund të ishin të dedikuara kryesisht për framework-et dhe më të rëndësishmet nga këto vlen të përmendim: React, Java, Python, Angular Js dhe Scram. Mund të fillohet njëherë me këto dhe më pas mund të zgjerohet oferta dhe me framework-e të tjerë. **Znj. Gishti** tha se, gjysmën e dytë të vitit 2024, AKAFPK do të dedikojë punën e vet për përgatitjen e kurrikulave të kurseve afatshkurtra të unifikuara që të jenë gati për tu ofruar vitin e ardhshëm.

4. Përcaktimi i agjendës për takimin e radhës

Lidhur me përcaktimin e agjendës së radhës, u vendos pranimi i ftesës së znj. Hedi Gjoni për të zhvilluar takimin në shkollën “Gjergji Canco”, ku anëtarët mund të njihen me shkollën, laboratorët, ambientet etj. Gjithashtu, **z. Xhina** propozoi që të zhvillohet një takim konsultativ me përgjegjës të departamenteve të IT-së në universitetet publike dhe pse jo dhe ato private. Takimi i radhës do të fokusohet edhe njëherë tek diskutimi dhe analiza e kurseve afatshkurtra, si dhe tek diskutimi për gjysmëpërçuesit.

➤ Vendime të marra nga mbledhja:

1. Të përgatitet kualifikimi pas të mesëm për “*IT support specialist*”.
2. IA të integrohet tek të gjitha kurrikulat për çdo profil të TIK.
3. Të përgatiten kurset afatshkurtra 3-6 mujore të dedikuar për disa framework-e si: React, Java, Python, Angular Js dhe Scram.
4. Të përgatitet një kurs afatshkurtër për “*Software-in*”.
5. Të vlerësohet mundësia e ofrimit të kualifikimit për gjysmëpërçuesit.